



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT  
D U R R Ë S**

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më 05.02.2018

**ANALIZA VJETORE**

*e*

**Prokurorisë Apelit Durrës për vitin 2017**

Më lejoni që nëpërmjet këtij materiali të paraqes në mënyrë të përmbledhur treguesit e përgjithshëm të punës dhe veprimtarisë së Prokurorisë Apelit Durrës dhe në mënyrë të vecantë të prokurorëve pranë kësaj prokurorie gjatë vitit 2017. Nga një vlerësim paraprak konstatohet se Prokurorët e Prokurorisë Apelit Durrës, gjatë vitit 2017 kanë ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin në gjykimim e çështjeve penale në shkallë të dytë, duke përballuar një volum të konsiderueshëm pune, kryesisht të çështjeve me objekt gjykimin e themelit të çështjeve.

Në vitin 2017 rezulton se janë regjistruar dhe gjykuar gjithsej 1596 çështje penale, nga të cilat 1537 çështje penale janë regjistruar gjatë këtij viti dhe 59 çështje të mbartura nga viti i kaluar <sup>1</sup>. Çështjet e regjistruara gjatë vitit 2017 i përkasin 918 çështje i përkasin fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës dhe alternativave të dënimit, kundërshtimit vendimeve të prokurorit etj., 344 janë çështje me karakter administrativo penal dhe 277 çështje me objekt vleftësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi.

<sup>1</sup> 57 çështje me objekt gjykimin e themeli dhe 2 çështje me objekt zëvendësim mase sigurimi

Në raport me vitin 2016, rezulton rritje me rreth 6% të çështjeve të gjykuara gjatë këtij viti në raport me vitin 2016.

Referuar llojit të veprave penale rezulton se veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike <sup>2</sup> zenë numrin me të madh të çështjeve që janë bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Durrës me 223 çështje si dhe veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike <sup>3</sup> me 213 çështje të gjykuara gjatë vitit 2017. Vend të rëndësishëm zenë edhe veprat penale kundër lirisë personit, moralit, fëmijëve dhe famijes me rreth 135 çështje të gjykuara, veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore si dhe ato kundër tokës në fushën e ndërtimeve <sup>4</sup>.

Treguesit analitik sipas llojit të veprave penale dhe rretheve gjyqore, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme;

Viti 2017	Durrës	Elbasan	Kavajë	Gjithsej
krimet kunder jetës dhe shëndetit nenet 76-83 k.p.	7	5	4	16
kundravajtjet penale ndaj shëndetit, nenet 84 -90	11	19	2	32
krimet seksual, neni 100-108 k.p.	1	5	1	7
krimet kundër lirisë, moralit dhe familjes, nenet 109-130/a k.p.	56	64	15	135
krimet kundër pasurisë dhe sferën ekonomike, nenet 134-162 k.p.	127	65	21	213
Krimet në fushën e doganave dhe tatimeve, nenet 171-182 k.p.	31	8	-	39
krimet e fallsifikimit monedhave e dokumentave, nenet 183-192 k.p.	21	18	3	42
v. penale kundër tokës, mjedisit e ndërtimeve, nenet 199-206 k.p.	30	24	8	62
v. penale kundër veprimtarisë shtetërore, nenet 235-260 k.p.	37	26	16	79
veprat penale rendit dhe sigurisë publike, nenet 261-293 k.p.	117	83	23	223
veprat penale kundër dejtësisë, nenet 300-324 k.p.	16	15	4	35

<sup>2</sup> Vepra penale këto të parashikuara nga nenet 261-293 të k.penal

<sup>3</sup> Vepra penale të parashikuara nga nenet 134-162 të k.penal

<sup>4</sup> Konstatohet se 79 çështje janë gjykuar për veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore dhe rreth 62 çështje për ndërtime të paligjshme.

Në vitin 2017 ka përfunduar gjykimi për 1548 çështje penale, në një kohë që në vitin 2016 janë përfunduar 1462 çështje. Sipas objektit të gjykimit rezulton se është përfunduar gjykimi në apel për 903 çështje me objekt themelin e çështjes, 279 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, 366 çështje administrativo penale. Ka përfunduar gjykimi për të gjitha çështje penale me objekt vlerësim, caktim dhe zëvendësim mase sigurimi, gjithsej 279 çështje nga të cilat 2 çështje të mbartura nga viti 2016. Nuk ka përfunduar gjykimi për 54 çështje themeli apo administrativo penale të cilat kryesisht janë planifikuar për gjykim në nëntor/dhjetor 2017.

Krahasuar me vitin 2016, rezulton se numri i çështjeve të përfunduar gjatë vitit 2017 është me i madh, për rrethet gjyqësore Durrës, Elbasan numri i çështjeve është e pothuajse e njëjtë, me rritje rrethi gjyqësor Kavajë, treguesit analitik krahasues paraqiten si më poshtë;

#### Çështjet e gjykuara gjatë vitit 2016

2016	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk. themeli	929	512	366	51
Masa sigurimi	267	151	101	15
Lirim me kusht	33	7	23	3
Gjykim të tjera	270	128	109	33
Totali	1499	798	599	102

#### Gjykime të përfunduara gjatë vitit 2017

2017	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk. themeli	903	469	337	97
Masa sigurimi	279	125	127	27
Lirim me kusht	33	12	17	4
Gjykime tjera	333	176	112	45
Totali	1548	782	593	173

Për vitin 2017, të ndara sipas rretheve gjyqësore, rezulton se ka përfunduar gjykimi për 1548 çështje, të ndara sipas rretheve gjyqësore rezulton se ; 782 çështje i përkasin rrethit gjyqësor Durrës, 593 çështje rrethit gjyqësor Elbasan dhe 173 rrethit gjyqësor Kavajë. Rezulton se prokurorët e rrethit gjyqësor Durrës kanë ushtruar gjithsej 227 ankime ndaj vendimeve të gjykatës faktit, prokurorët e rrethit gjyqësor Elbasan 113 ankime, ndërsa prokurorët e rrethit gjyqësor Kavajë 21 ankime. Treguesit analitik sipas rretheve gjyqësore, sipas objektit gjykimit, dhe subjektit ankimues, krahasuar me vitin 2016, paraqiten sipas tabelave të mëposhtme;

#### Cështjet e gjykuara gjatë vitit 2016

2016	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk them e objek tjera	1232	647	498	87
Masa sigurimi	267	151	101	15
Ank. Pandeh.	1151	602	468	81
Ank. Prokurori	348	196	131	21
Totali	1499	798	599	102

#### Cështjet të përfunduara gjatë vitit 2017

2016	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk them e objek tjera	1269	657	466	146
Masa sigurimi	279	125	127	27
Ank. Pandeh.	1187	555	480	152
Ank. Prokurori	361	227	113	21
Totali	1548	782	593	173

Cështje me objekt gjykimin e themelit; Ka përfunduar gjykimi i cështjeve objekt fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës dhe alternativat e dënimit, gjithsej 903 cështje, të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin 469 rrethit gjyqësor Durrës, 337 rrethit gjyqësor Elbasan dhe 97 rrethit gjyqësor Kavajë. Për këto cështje rezulton se në 671 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të pandehurve/mbrojtësve dhe 232 raste mbi ankimin e prokurorëve.

Cështje administrative penale; Ka përfunduar gjykimi i cështjeve objekt ankim ndaj vendimeve të prokurorit, ekstradimet dhe njohjen e vendimeve penale të huaja, gjykimet në fazën e ekzekutimit vendimeve penale etj., gjithsej 363 cështje, të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin 188 rrethit gjyqësor Durrës, 129 rrethit gjyqësor Elbasan dhe 49 rrethit gjyqësor Kavajë. Për këto cështje rezulton se në 284 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të pandehurve/mbrojtësve dhe 79 raste mbi ankimin e prokurorëve.

Cështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi; Ka përfunduar gjykimi i cështjeve objekt vleftësim, caktim apo zëvendësim mase sigurimi, gjithsej 279 cështje, të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin 125 rrethit gjyqësor Durrës, 127 rrethit gjyqësor Elbasan dhe 27 rrethit gjyqësor Kavajë. Për këto cështje rezulton se në 227 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të pandehurve/mbrojtësve dhe 52 raste mbi ankimin e prokurorëve.

Nga këta tregues rezulton se kundërshtimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të shkallës parë është bërë gati në 1/3 e cështjeve nga ana e prokurorëve, raport ky i cili nuk ndryshon nga vitet e mëparshme.

**Për rrethin gjyqësor Durrës** rezulton se janë gjykuar gjithsej 782 cështje penale, 657 cështje themeli dhe administrative penale dhe 125 cështje me objekt vleftësim dhe

caktim mase sigurimi. Raporti si subjekte ankuese rezulton se nga të pandehurit është ushtruar ankim në 555 raste ndërsa nga ana e prokurorit vetëm në 227 raste. Nga 125 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, të kësaj prokurorie në 98 raste kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të dyshuarve, pandehurve dhe në 27 raste mbi ankimin e prokurorit. Nga treguesit e mësipërm rezulton se më shumë se 50 % e çështjeve i përkasin kësaj prokurorie, numri i çështjeve për këtë rreth gjyqësor është i pothuaj i njëjtë krahasuar me vitin 2016.

**Për rrethin gjyqësor Elbasan** rezulton se janë gjykuar gjithsej 593 çështje penale, 466 çështje themeli dhe administrative penale si dhe 127 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Raporti si subjekte ankuese rezulton se nga të pandehurit është ushtruar ankim në 480 raste ndërsa nga ana e prokurorëve vetëm në 113 raste. Nga 127 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, të kësaj prokurorie në 108 raste kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të dyshuarve, pandehurve dhe në 19 raste mbi ankimin e prokurorit.

Për çështjet e themeli, administrative penale dhe ato me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi konstatohet rënie e ankimeve të prokurorëve në raport me ankimet e të pandehurve si dhe vitin 2016. Nga treguesit e mësipërm rezulton se numri i çështjeve të gjykuara në shkallë të dytë për këtë rreth gjyqësor është në rënie.

**Për rrethin gjyqësor Kavajë** rezulton se janë gjykuar gjithsej 173 çështje penale, 146 çështje themeli dhe administrative penale si dhe 27 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Nga 27 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, të kësaj prokurorie në 21 raste kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të dyshuarve, pandehurve dhe në 6 raste mbi ankimin e prokurorit. Nga treguesit e mësipërm rezulton numri i çështjeve të gjykuara gjatë vitit 2017 për këtë rreth gjyqësor është rritur ndjeshëm ndonëse numri i ankimeve të prokurorëve ka mbetur i njëjtë.

Cështjet e gjykuara mbi ankimin e prokurorit; Gjatë vitit 2017, mbi ankimin e prokurorëve të prokurorive të shkallës parë, janë gjykuar gjithsej 361 cështje nga 348 cështje që janë gjykuar në vitin 2016. Të ndara sipas rretheve gjyqsore, rezulton se 227 cështje, ankime i përkasi Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 113 cështje, ankime Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 21 ankime Prokurorisë Rrethit Kavajë.

Cështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e prokurorit, të ndara sipas rretheve gjyqsore dhe objektit gjykimit, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prokurorit	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
Gjyk themeli	138	69	9	216
Ad. penale	51	23	5	79
Masa sigurimi	27	19	6	52
Të mbartura nga viti 2016	11	2	1	14
Totali	227	113	21	361

Objekt i ankimeve të ushtruara nga prokurorët e shkallës parë në rreth 60% të cështjeve kanë patur kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të rrethit gjyqësor në lidhje me themelin e cështjeve, për deklarimin fajtor, cilësimin ligjor të veprës penale, llojin dhe masën e dënimit dhënë të pandehurve. Një numër i konsiderueshëm i ankimeve i përkthet aplikimit të dënimeve alternative të dhënë nga gjykatat e faktit për të cilat prokurorët nuk kanë qenë dakord dhe kanë ushtruar ankim në shkallë të dytë.

Nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie rezulton se është përkrahur ankimi në 241 ankime nga 361 ankime të ushtruara. Është deklaruar heqja dorë nga ankimi në 51 raste si dhe është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimit për shkak amnistie në 69 raste.

Rastet e mospërkrahjes, heqjes dorë nga ankimi i prokurorëve të shkallës parë, të ndara rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Hequr dorë nga ankimi Prokurorit	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
F. Elezi	2	2	--	4
K. Luli	6	1	--	7
B. Hoti	6	5	1	12
L. Dodaj	9	2	1	12
M. Duda	9	5	-	14
Gjithsej	33	16	2	49

Heqjet dorë nga ankimi i prokurorëve. Sikurse rezulton nga treguesit analitikë, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se është deklaruar heqja dorë vetëm në 49 raste nga 361 ankime të ushtruara, të cilat zënë reth 13.6% të totalit ankimeve të ushtruara. Rastet e heqjeve dorë i përkasin 33 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 16 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 2 raste Prokurorisë Rrethit Kavajë. Në përgjithësi rastet e heqjes dorë nga ankimi i përkasin ankimeve për kundërshtimin e aplikimit të dënimeve alternative sipas neneve 59, 63 të k.penal apo për masë dënimi. Në përgjithësi të gjitha rastet heqjeve dorë nga ana e prokurorëve ato janë diskutuar paraprakisht me prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe drejtuesin e prokurorive, vlerësohet se për cdo rast të heqjeve dorë nga ankimi, prokurorët janë bazuar në bindjen e tyre të brendëshme si dhe bazuar në kërkesat e ligjit penal material e procedural penal. Në mjaft raste ankimet e ushtruara nga ana e prokurorëve të prokurorive të rrethit gjyqësor, dhe sidomos por këto çështje rezultojnë të paargumetuar dhe të pa bazuara në prova dhe në ligj. Kjo problematikë është bërë prezente verbalisht prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, pasqyruar në konkluzionet përkatëse të prokurorëve të apelit. Kosntatohet gjithashtu se vetëm për aplikimin e dënimeve alternative apo



masë dënimi, për veprën penale të dhunës në familje, ndërtimit të paligjshëm apo drejtimit mjetit në mënyrë të parregullt, nga prokuroritë e rretheve është ushtruar një numër i konsiderueshëm ankimesh.

Ankimet e prokurorëve të pranuar nga gjykata apelit. Sikurse rezulton nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se është përkrahur ankimi mbi 85 % të rasteve, nga 361 ankime janë përkrahura 319 ankime dhe është deklaruar heqja dorë vetëm në 49 raste. Nga 319 rastet e përkrahura të ankimit të prokurorëve rezulton se nga ana e Gjykatës Apelit Durrës, janë pranuar 62 prej tyre ose rreth 19% e ankimeve. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 41 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 15 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 6 ankime Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Rastet e ankimeve të pranuar dhe të përkrahura nga gjykata e apelit Durrës, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prok i pranuar	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
F. Elezi	8	4	2	14
K. Luli	8	1	3	12
B. Hoti	12	2	1	15
L. Dodaj	7	4	-	11
M. Duda	6	4	-	10
Gjithsej	41	15	6	62

Rekurset e ushtruara. Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e prokurorëve të apelit në seancë gjyqësore, apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë në 175 raste, nga 193 rekurse të ushtruara gjatë vitit 2016. Sipas rretheve gjyqësore, rezulton se 92 Rekurse janë ushtruar për çështje të rrethit gjyqësor Durrës, 62

Rekurse për çështje të rrethit gjyqësor Elbasan dhe 21 Rekurse për çështje të rrethit gjyqësor Kavajë.

Sipas çështjeve llojit të çështjeve objekt gjykimi rezulton se janë ushtruar 117 rekurse për çështje themeli, 26 rekurse ndaj vendime me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi dhe 32 rekurse për çështje administrative penale.

Rastet e rekurseve të ushtruara nga secili prokuror të ndara sipas objektit të gjykimit çështjes, treguesit paraqiten si më poshtë;

Rekurset	Çështje themeli	Masa sigurimi	Admin. penale	Gjithsej
F. Elezi	10	4	4	18
M. Duda	24	9	8	41
L. Dodaj	20	4	4	31
B. Hoti	23	6	8	37
K. Luli	40	4	4	48
Gjithsej	92	64	21	175

Për çështjet penale me objekt lirim para kohe sipas nenit 64 të k.penal. Gjatë vitit 2017 janë bërë objekt gjykimi 33 çështje kryesisht mbi ankimin e prokurorëve ndaj vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore të cilat kanë pranuar kërkesat e të dënuarve për lirim para kohe. Numri i çështje me këtë objekt gjykimi, ndonëse rezulton i ulët për shkak të veprimit të ligjeve për dhënie amnistie, në përgjithësi evidenton formalizëm në ankimin e prokurorve të shkallës parë, nuk bëhet analizë e kërkesave të ligjit si dhe rrethanave dhe sidomos vecorive të dënuarit objekt gjykimi në raport edhe me praktikën gjyqësore të unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës Lartë me vendimin Nr 2 datë 25.05.2015.

Çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Këto çështje bëhen objekt gjykimi në gjykatën e apelit kryesisht mbi ankimin e palëve ndaj vendimeve administrative penale të prokurorisë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore. Gjatë vitit 2017 ka

përfunduar gjykimi për 145 çështje me këtë objekt gjykimi, afërsisht sa dyfishi i çështjeve të gjykuara në vitin 2016, kjo edhe për shkak të ndryshimeve të ligjit procedural penal në lidhje me afatet e gjykimit të këtyre çështjeve. Këto çështje janë bërë objekt gjykimi në shkallë të dytë mbi ankimin e palëve, prokurorit apo personave të interesuar. Për këto çështje duhet të evidentojmë faktin se nga prokurët e prokurorive të rretheve gjyqësore në mjaft raste mbahen qëndrime të gabuara, ndonëse kryen veprime hetimore dhe çështja duhet të regjistrohet edhe për shkak të elementëve të kallëzimeve, nga ana e prokurorëve vendoset mosfillimi i procedimit penal, në mjaft raste jo të bazuara në prova dhe ligj. Konstatohet rritje e ndjeshme e numrit të çështjeve në të cilat nga ana e gjykatave të shkallës parë dhe apelit është vendosur shfuqizimi i vendimeve të prokurorëve për mosfillimin e procedimit penal.

Çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorit për pushimin e procedimit penal. Këto çështje bëhen objekt gjykimi në gjykatën e apelit kryesisht mbi ankimin e palëve ndaj vendimeve të prokurorisë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore. Gjatë vitit 2017 ka përfunduar gjykimi për 52 çështje me këtë objekt gjykimi, çështje të cilat i përkasi periudhës para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të K.Pr.Penale <sup>5</sup>. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit procedural nga ana e gjykatës apelit Durrës gjykimi në shkallë të dytë i këtyre çështjeve bëhet në dhomë këshillimi.

Në punën e tyre të përditshme, prokurorët e apelit i kushtojnë një rëndësi shumë të madhe edhe momentit pas përfundimit të gjykimit të çështjeve që përfaqsohen nga ana e tyre. Cdo prokuror nxjerre problemet ligjore që ka patur në çdo çështje dhe ia bën prezent ato prokurorit të çështjes në prokuroritë e shkallës së parë, ben urdherat e ekzekutimit për vendimet që duhen ekzekutuar menjehere si dhe ushtron rekurse në Gjykatën e Lartë, për vendimet me të cilat nuk është

---

<sup>5</sup> Parashikimet e nenit 329/7 të K.Pr.Penale, ndryshuar me ligjin Nr 35/2017, hyre në fuqi në datë 01.08.2017

dakort. Per ato raste kur nuk kemi qene dakort me vendimin e gjykates dhe kemi qene te bindur se egzistonin kriteret ligjore te percaktuara ne nenin 432 te K.Pr.Penale, kemi ushtruar rekurs ne Gjykatën e Lartë Tirane.

Mbi ekzekutimin e vendimeve penale. Në kete faze nga ana e prokuroreve te Prokurorise se Apelit Durres, eshte kryer nje volum i konsiderueshem pune, e cila konsiston jo vetem ne berjen e urdherave te ekzekutimit, por edhe ne pergatitjen e dokumentacionit te nevojshem qe i dergohet prokurorive te rretheve me qellim ekzekutimin e vendimeve te gjykates qe nuk jane me ekzekutim te menjehershem, nga prokuroret e ekzekutimeve te vendimeve qe ndodhen prane ketyre prokurorive. Nga prokuroret e Prokurorise se Apelit Durres, jane nxjerre urdhera ekzekutimi te natyrave te ndryshme, urdhera arrestimi, urdhera lirimi si dhe urdhera ekzekutimi per kalimin nga njera mase sigurimi ne nje mase tjeter sigurimi. Urdherat e arrestimit u jane derguar menjehere policive gjyqesore te komisariteve perkatese. Ndersa urdherat e lirimit jane ekzekutuar nga sektorët juridik pranë I.E.Vendimeve Penale, bazuar në urdhërat e prokurorit cështjes pranë kësaj prokurorie. Ne keto raste eshte bere lirimi i menjehershem i personave te arrestuar dhe u eshte njoftuar mase tjeter e sigurimit ne rastet kur gjykata ka caktuar mase tjeter sigurimi. Urdherat e ekzekutimit jane nxjere jo vetem per masat e sigurimit, por edhe per lirimet me kusht si dhe per ceshtje për të cilat ka përfunduar gjykimi në themel. Për cështje me objekt gjykimi themeli, per te bere te mundur ekzekutimin e vendimeve te formes se prere, jane derguar për ekzekutim praktikat ne prokurorite e rretheve perkatese, brenda afateve te percaktuara ne Urdherin e Prokurorit te Pergjithshem. Keto praktika jane kryesisht per ceshtjet e gjykuara ne themel, per te cilat eshte lene ne fuqi vendimi i gjykates shkalles se pare dhe te pandehurit jane denuar me burgim, por nuk kane patur mase sigurimi apo kane patur masa, te cilat nuk i pergjigjen llojit te denimit te dhene, si dhe per gjykimet me objekt lirim me kusht

ne rastet kur eshte ndryshuar vendimi dhe eshte rrezuar kerkesa e te denuarit nga gjykata e apelit.

Organizimi, përfaqësimi i akuzës dhe ushtrimin e ndjekjes penale në Prokurorinë e Apelit Durrës. Organizimi i brendshëm i punës, përfaqësimi i akuzës në gjykim dhe ushtrimin e ndjekjes penale në Prokurorinë e Apelit Durrës, bëhet bazuar në urdhërat e brendëshëm Nr 1 dhe Nr 2 datë 09.01.2014 të drejtuesit të kësaj prokurorie.

Cështjet e planifikuara për gjykim nga ana e gjykatës apelit Durrës merren nga kryesekretaria e kësaj prokurorie dhe regjistrohet në regjistrin elektronik duke pasqyruar të gjithë treguesit e nevojshëm. Grupimi i dosjeve penale bëhet menjëherë nga drejtuesi i kësaj prokurorie i cili në prani të gjithë prokurorëve dhe sekretarisë organizon dhe realizon hedhjen e shortit. Pas hedhjes së shortit prokuroët marrin menjëherë dosjet e caktuara me short dhe nga administrata e prokurorisë bëhet fotokopjimi i akteve të nevojshme dhe ja dorëzon ato secilit prokuror.

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Apelit Durrës, dhe jo vetëm pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e ligjore si rezultat i reformës në drejtësi, vlerësimi dhe vendimarrja e prokurorëve në cdo rast ka qenë e bazuar në vlerësimin dhe bindjen e tyre të brendëshme dhe me pavarësi të plotë.

Objekt i punës së Prokurorëve të kësaj prokurorie është edhe verifikimi dhe vlerësimi i problematikave në ushtrimin e ndjekjes penale nga ana e Prokurorisë të Rrethve Gjyqësore Durrës, Elbasan dhe Kavajë, gjatë hetimit dhe gjykimit të këtyre çështjeve penale. Në këtë drejtim nga të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie duhet bërë më shumë dhe sidomos në evidentimin e tyre në akte përkatëse.

#### Ngarkesa dhe treguesit e punës për secilin Prokuror

**Prokurori Moisi Duda.** Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2017 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 337 çështjeve penale, nga të cilat 14 çështje kanë

qenë të mbartura nga viti 2016. Nuk ka përfunduar gjykimin për 18 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2017. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 202 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 79 çështje administrative penale dhe 57 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 79 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 51 çështje themeli, 17 çështje administrative penale dhe 11 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Cështjet të përfunduara nga Prokurori Moisi DUDA vitit 2017

Viti 2017	Ankim Prokurorit	Ankim i të Pandehurit etj.	Totali
Gjyk themeli	51	151	202
Ad. penale	17	61	79
Masa sigurimi	11	46	57
Të mbart - 2016	13	4	17
Totali	79	258	337

Nga 79 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqsuara në ana e prokurorit Moisi Duda, gjatë vitit 2017 rezulton se janë përkrahur 49 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 16 raste si dhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 14 raste. Heqjet dorë nga ankimi i përkasin 9 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 5 raste ankimeve të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Në përgjithësi kërkesat e këtij prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e

gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit në konkluzionet paraqitur gjykatës, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 10 raste të cilat i përkasi 6 ankime të prokurorisë Durrës si dhe 4 ankime të prokurorisë Elbasan. Sipas objekti rezulton se janë pranuar nga gjykata 6 ankime për çështje themeli, 3 ankime për çështje administrative penale dhe 1 ankim për masë sigurimi.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 41 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 19 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 17 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 5 rekurse rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 24 raste për çështje me objekt themelin e tyre, 9 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 8 raste për vendime administrative penale.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Moisi Duda, është karakterizuar nga ndjenja e përgjegjësise, korrektësi dhe përkushtimi në punë. Perfaqsimi në gjykim rezulton, profesional dhe ligjor, ka paraqitur në çdo rast konkluzionet me shkrim para gjykatës dhe të argumentuara. Gjatë këtij vitit 2017 ai ka përballuar ngarkese të madhe dhe me probleme juridike të çështjeve, të cilave u ka dhënë gjithmonë zgjidhje të drejte ligjore. Nuk rezulton që seancat gjyqësore të jenë shtyrë për mosparaqitje të këtij prokurori në gjykim. Në përgjithësi ka diskutuar problematikat e çështjeve me prokurorët e shkallës parë, prokurorët dhe

drejtuesin e prokurorisë apelit për dhënien e zgjidhjeve sa më ligjore e profesionale. Rastet e mospërkrahjes së ankimit prokurorëve apo qëndrimet e mbajtura në gjykimet në shkallë të dytë, janë bërë sipas bindjes brendëshme bazuar në kërkesat e ligjit dhe provat e administruara. Duhet rritur niveli i evidentimit të problematikave në veprimtarinë e pol gjyqsore dhe prokurorëve të shkallës parë. Puna e këtij prokurori për vitin 2017 në të gjithë treguesit vlerësohet si “shumë mirë”.

**Prokurori Ludovik Dodaj.** Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2017 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 339 çështjeve penale, nga të cilat 17 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2016. Nuk ka përfunduar gjykimin për 12 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2017. Sipas objektit të gjyimit, rezultojnë 200 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 84 çështje administrative penale dhe 55 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 79 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 51 çështje themeli, 16 çështje administrative penale dhe 12 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Cështjet të përfunduara nga Prokurori Ludovik DODA vitit 2017

Viti 2017	Ankim Prokurorit	Ankim i të Pandehurit etj.	Totali
Gjyk themeli	51	149	200
Ad. penale	16	68	78
Masa sigurimi	12	43	55
Të mbart - 2016	2	1	3
Totali	79	260	339

Nga 79 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqsuara në ana e prokurorit Ludovik Doda, gjatë vitit 2017



rezulton se janë përkrahur 47 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 20 raste si dhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 12 raste. Heqjet dorë nga ankimi i përkasin 9 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 2 raste ankimeve të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 1 ankim prokurorisë rrethit gjyqësor Kavajë. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 11 raste të cilat i përkasi 7 ankime të prokurorisë Durrës si dhe 4 ankime të prokurorisë Elbasan. Sipas objekti rezulton se janë pranuar nga gjykata 7 ankime për çështje themeli, 2 ankime për çështje administrative penale dhe 2 ankime për masë sigurimi.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 31 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 18 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 11 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 1 rekurs rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 20 raste për çështje me objekt themelin e tyre, 3 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 8 raste për vendime adminsitative penale.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në

Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Ludovik Dodaj, karakterizohet nga ndjenja e përgjegjësisë, korrektësi dhe përkushtimi në punë. Ky prokuror ka përballuar ngarkese të madhe dhe me probleme juridike të çeshtjeve, të cilave është përpjekur të japë gjithmone zgjidhje të drejta juridike. Evidentohet për perfaqsimin e proçeseve me probleme në raport me provat dhe gjykimin e tyre të pjeshem në gjykimin në shkallë të dytë. Duhet të rritet niveli i evidentimit të problematikave apo qëndrimeve jo ligjore të prokurorëve të shkallës parë. Nuk rezulton që seancat gjyqësore të jenë shtyrë për mosparaqitje të këtij prokurori në gjykim. Diskuton dhe analizon problematikën e çështjeve me prokurorët e shkallës parë, prokurorët dhe drejtuesin e prokurorisë për zgjidhjen sa më ligjore të çështjeve. Rastet e mospërkrahjes së ankimit prokurorëve apo qëndrimet e mbajtura në gjykimet në shkallë të dytë, janë bërë sipas bindjes brendëshme bazuar në kërkesat e ligjit dhe provat e administruara. Puna e këtij prokurori për vitin 2017 në të gjithë treguesit vlerësohet si “shumë mirë”.

**Prokurori Bujar Hoti**. Nga ky prokuror gjatë vitit 2017 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 337 çështjeve penale, nga të cilat 9 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2016. Nuk ka përfunduar gjykimin për 15 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2017. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 193 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 81 çështje administrative penale dhe 63 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 86 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 50 çështje themeli, 23 çështje administrative penale dhe 13 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

## Cështjet të përfunduara nga Prokurori Bujar HOTI vitit 2017

Viti 2017	Ankim Prokurorit	Ankim i të Pandehurit etj.	Totali
Gjyk themeli	50	143	193
Ad. penale	23	58	81
Masa sigurimi	13	50	63
Të mbart - 2016	2	7	9
Totali	86	251	337

Nga 86 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqsuara në ana e prokurorit Bujar Hoti, gjatë vitit 2017 rezulton se janë përkrahur 48 ankime, nga të cilat 2 ankime prokurori për çështje të mbartura nga viti kaluar. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie.. në 24 raste si dhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 12 raste. Heqjet dorë nga ankimi i përkasin 6 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 5 raste ankimeve të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 1 rast ankimi të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në dy çështje është hequr dorë nga ankimi nga vetë prokurorët e shkallës parë. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 15 raste të cilat i përkasi 12 ankime të prokurorisë Durrës, 2 ankime të prokurorisë Elbasan si dhe 1 ankim të prokurorisë rrethit Kavajë. Sipas objekti rezulton se janë pranuar nga gjykata 7 ankime për çështje themeli, 3 ankime për çështje administrative penale dhe 5 ankime për masë sigurimi.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet

e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 37 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 16 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 14 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 7 rekurse rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 23 raste për çështje me objekt themelin e tyre, 6 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 8 raste për vendime administrative penale.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Bujar Hoti, për periudhën e mësipërme ka përballuar ngarkese të konsiderueshme pune, për çështje me probleme juridike të cilave në përgjithësi u ka dhënë zgjidhje të drejte juridike në përputhje me provat dhe bindjen e tij. Evidentohet për perfaqsimin e proçeseve me probleme në raport me provat dhe gjykimin e tyre të pjesshëm në shkallë të dytë. Perfaqsimi në gjykim rezulton të jetë ligjor, në çdo rast konkluzionet janë dhënë me shkrim para gjykatës. Nuk rezulton që të jenë shtyrë seancat gjyqësore për mosparaqitje të këtij prokurori. Duhet të rritet niveli i evidentimit të problematikave apo qëndrimeve jo ligjore të prokurorëve të shkallës parë. Në rastet e heqjeve dorë nga ankimi i prokurorëve apo qëndrimet e mbajtura në gjykimet në shkallë të dytë janë bërë sipas bindjes brendëshme bazuar në kërkesat e ligjit dhe aktet e dosjeve. Puna e këtij prokurori për vitin 2017 në të gjithë treguesit vlerësohet si “shumë mirë”.

4. **Prokurori Kujtim Luli.** Nga prokuror Kujtim Luli gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2017 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 322 çështjeve penale, nga të cilat 10 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2016. Nuk ka përfunduar gjykimin për 112 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2017. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 193 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 70 çështje administrative penale dhe 59 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 79 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 47 çështje themeli, 16 çështje administrative penale dhe 12 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Cështjet të përfaqsuara nga Prokurori Kujtim LULI vitit 2017

Viti 2017	Ankim Prokurorit	Ankim i të Pandehurit etj.	Totali
Gjyk themeli	47	146	193
Ad. penale	16	54	70
Masa sigurimi	12	47	59
Të mbart - 2016	4	6	10
Totali	79	251	322

Nga 79 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqsuara në ana e prokurorit Kujtim Luli, gjatë vitit 2017 rezulton se janë përkrahur 58 ankime, nga të cilat 4 ankime prokurori për çështje të mbartura nga viti kaluar. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie.. në 14 raste si dhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 7 raste. Heqjet dorë nga ankimi i përkasin 6 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 1 rast ankimi Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe kanë qenë në

përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 12 raste të cilat i përkasi 8 ankime të prokurorisë Durrës, 1 ankim të prokurorisë Elbasan si dhe 3 ankim të prokurorisë rrethit Kavajë. Sipas objekti rezulton se janë pranuar nga gjykata 4 ankime për çështje themeli, 4 ankime për çështje administrative penale dhe 4 ankime për masë sigurimi.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 48 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 32 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 13 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 3 rekurse rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 40 raste për çështje me objekt themelin e tyre, 4 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 4 raste për vendime administrative penale.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

Prokurori Kujtim Luli, karakterizohet nga ndjenja e përgjegjësise, korrektësisë dhe përkushtimi në pune. Nga ky prokuror është përballuar ngarkese të madhe dhe me probleme juridike të çështjeve, të cilave u ka dhënë gjithmonë zgjidhje të drejte juridike. Përfaqsimin në gjykim rezulton të jetë i

arsyetuar, profesional dhe ligjor. Nga ky prokuror janë paraqitur ne çdo rast konkluzionet me shkrim para gjykates, të arsyetuar dhe me praktikë të gjykatës lartë. Evidenton problematik dhe qëndrimet e prokurorëve të shkallës parë, gjykatave të rretheve gjyqësore si dhe të gjykatës apelit. Diskuton dhe analizon me prokurorët e shkallës parë, prokurorët dhe drejtuesin e prokurorisë apelit për dhënien e zgjidhjeve sa më ligjore e profesionale. Rastet e mospërkrahjes së ankimit prokurorëve apo qëndrimet e mbajtura në gjykimet në shkallë të dytë, janë bërë sipas bindjes brendëshme bazuar në kërkesat e ligjit dhe provat e administruara. Puna e këtij prokurori për vitin 2017 në të gjithë treguesit vlerësohet si “shumë mirë”.

5. **Prokurori Ferdinand Elezi**. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2017 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 261 çështjeve penale, nga të cilat 3 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2017. Nuk ka përfunduar gjykimin për 1 çështje themeli e cila është mbartur për vitin 2017. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 165 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes, 51 çështje administrative penale dhe 45 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 48 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 29 çështje themeli, 13 çështje adminsitrateve penale dhe 16 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Cështjet të përfaqësura nga Prokurori Ferdinand ELEZI vitit 2017

Viti 2017	Ankim Prokurorit	Ankim i të Pandehurit etj.	Totali
Gjyk themeli	29	136	165
Ad. penale	13	38	51
Masa sigurimi	6	39	45
Të mbart - 2016	-	3	3
Totali	48	213	261

Nga 48 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqsuara në ana e prokurorit Ferdinand Elezi, gjatë vitit 2017 rezulton se janë përkrahur 33 ankime. Është kërkuar lënia në fuqi, miratimi apo prishja e vendimeve për shkak amnistie në 11 raste si dhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 4 raste. Heqjet dorë nga ankimi i përkasin 2 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 2 raste ankimi Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në cdo rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe kanë qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.

Nga ankimet e prokurorëve të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga gjykata e apelit në 14 raste të cilat i përkasi 8 ankime të prokurorisë Durrës, 4 ankime të prokurorisë Elbasan si dhe 2 ankim të prokurorisë rrethit Kavajë. Sipas objekti rezulton se janë pranuar nga gjykata 5 ankime për çështje themeli, 6 ankime për çështje administrative penale dhe 3 ankime për masë sigurimi.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 18 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 7 Rekurse për rrethit gjyqësor Durrës, 7 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 4 rekurse rrethit gjyqësor Kavajë. Sipas objektit të gjykimit çështjeve është ushtruar rekurs në 10 raste për çështje me objekt themelin e tyre, 4 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi si dhe 4 raste për vendime administrative penale.



Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, nga ky prokuror nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke pasqyruar qëndrimin e tij në kartelën e fashikullit penal.

**Konkluzione, objektiva e rekomandime.** Prokuroria e Apelit Durrës, ka mbajtur marrëdhënie korrekte dhe ligjore, me organet e tjera, në raport me kryerjen e detyrave të saj, Kushtetuese dhe ligjore. Marrëdhënie korrekte dhe ligjore prokuroria e apelit ka patur me Gjykatën e Apelit dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore. Qëndrimet e mbajtura dhe vendimarrja në disa raste të Gjykatës Apelit Durrës ka qenë tërësisht e gabuar dhe në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit penal material dhe atë procedural penal si dhe vendimet unifikuese të Gjykatës Lartë.

Me prokurorët e shkallës parë janë diskutuar vazhdimisht çështjet objekt gjykimi, problematikat që janë hasur dhe ecuria e çështjeve. Prokurorët e kësaj prokurorie kanë patur pjesëmarrje të rregullt në seanca gjyqësore, nuk ka patur asnjë që të shtyhet pa shkaqe objektive. Prokurorët shkojnë gjithmonë të përgatitur në gjykim dhe në çdo rast i paraqesin gjykatës konkluzione me shkrim dhe të argumentuara në prova dhe ligj.

Pavarësisht punës së deritanishme është e domosdoshme përmirësimi i saj për vitin 2018 e në vazhdim për realizimin e veprimtarisë të ushtrimit ndjekjes penale dhe përfaqësimit akuzës në gjykim në mënyrë sa më të efektshme e pasqyruar me rezultate më të larta.

Gjatë vitit 2017 nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përfaqësuar akuzën penale në gjykim në shkallë të dytë në mënyrë sa më efektive, dhe profesionale, bazuar në kërkesat e ligjit dhe provat që janë administruara në çdo çështje penale.

Problem shqetësues mbetet veprimtaria hetimore e prokurorëve dhe policisë gjyqësore në drejtim të marrjes dhe

administrimit të provave, të respektimit të kërkesave të ligjit procedural dhe formalizimit të kësaj veprimtarie në akte procedurale.

Ndonëse edhe në vitet e kaluara janë evidentuar mjaft raste të vendimeve të mosfillimit apo të pushimit të procedimit penal pa kryer veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme hetimore dhe me vendimarrje të gabuar. Numri i vendimeve të gjykatës për shfuqizim e vendimit mosfillimit për vitin 2017 ka qenë më i madh se vitet e kaluara cka tregon se vlerësimi i prokurorëve në momentet e para të trajtimit të materiale kallëzuese ka qenë formal dhe i gabuar.

Gjithashtu janë konstatuar edhe cilësime ligjore të gabuara të kualifikimit të veprës penale ndaj të pandehurve dhe në jo pak raste për çështje që vijnë për tu gjykuar në apel vetëm mbi ankimin e të pandehurve, duke bërë të pamundur edhe reagimin dhe korigjimin ligjor.

Jo në pak raste konstatohen ankime të cilat ushtrohen formalisht dhe janë të pa argumentuara nga ana e prokurorëve të shkallës parë, cka ndikon drejtpërdrejtë edhe në qëndrimin, punën dhe rezultatet në gjykimin e çështjeve edhe në shkallë të dytë. Referuar ndryshimeve të ligjit procedural penal në nenin 425 të K.Pr.Penale, nga prokurorët e shkallës parë duhet detyrimisht që në aktin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, shkaqet e ankimit duhet të jenë të plota. Kjo për shkak të detyrimit të mësipërm që ka gjykata e apelit për ta shqyrtuar çështjen brenda kufijve dhe shkaqeve të ngritura në ankim <sup>6</sup>.

Gjithashtu referuar ndryshimeve ligjore, parashikimet e nenit 427/4 të K.Pr.Penale, në rastet e deklarimeve të pafajësisë së të pandehurve, nga ana e prokurorëve duhet që për këto çështje të evidentohen ato prova të cilat duhet të shqyrtohen në gjykimin në apel në mënyrë të detyrueshme për ndryshimin e vendimeve të gjykatës faktit.

Duhet evidentuar fakti se një pjesë e gjykimeve në shkallë të dytë nga gjykata e apelit bëhen në dhomë këshillimi dhe

---

<sup>6</sup> Referuar percaktimit ne nenin 425/1 te K.Pr.Penale

bazuar vetëm në aktin e ankimit të prokurorit. Në këto kushte duhet të rritet kujdesi dhe përgjegjësia e prokurorëve për rritjen e nivelit argumentues në ankimet e ushtruara.

Kërkohet në mënyrë të detyrueshme rritja e nivelit profesional dhe sidomos të ballafaqimit dhe të zbatimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Rritja e forcës arsyetuese dhe përgatitje sa më serioze, për çdo çështje e procedim, pamvarësisht akuzës dhe rëndësisë në gjykimin në shkallë të dytë.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie duhet që të evidentojnë çdo problematikë që konstatohet në veprimet e prokurorëve të shkallës parë policisë gjyqësore, me qëllim jo vetëm rritjen e përgjegjësisë prokurorëve por edhe parandalimin e qëndrimeve dhe veprimeve në kundërshtim me ligjin. Vëmendja e veçantë duhet ti kushtohet edhe kundërshtimit të arsyetuar të vendimeve të gjykatave shkallës parë dhe të gjykatës apelit.

Marrja e masave të nevojshme për zbatimin me korrektësi të kodit drejtësisë penale për të miturit.

Duhet të rritet forca arsyetuese dhe ligjore në Rekursin e ushtruara në Gjykatën e Lartë.

Bashkëpunim i vazhdueshëm me prokurorët e shkallës së parë për problematikën e çështjes, mënyrën e zgjidhjes, verifikimin e pretendimeve, sqarimin e rrethanave etj..

Këto ishin disa nga treguesit e punës së prokurorisë së Apelit Durrës, për vitin 2017, që u munduan të trajtojnë në mënyrë të përbledhur në këtë material. Duke vlerësuar atë si jo të plotë, mirëpresim pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Durrës, më 02.02.2018.

**DREJTUESI I PROKURORISË APELIT**  
**Ferdinand ELEZI**